

Lëndë e rregullimit

(1) Me këtë ligj rregullohet organizimi dhe përgjegjësia në kryerjen e veprimtarisë së veterinarisë, parimet dhe procedurat për implementimin e aktiviteteve të lidhura me mbrojtjen e kafshëve dhe njerëzve dhe njerëzve nga sëmundjet të cilat barten nëpërmjet kafshëve, prodhimeve, nus-prodhimeve me origjinë shtazore dhe lëndëve, aktiviteteve kundër sëmundjeve ngjitëse të kafshët, duke përfshirë zoonozët, punën e Odës së Veterinarisë dhe çështje tjera me rëndësi për veprimtarinë e veterinarisë.

(2) Me këtë ligj rregullohet edhe kontrolli dhe çrrënjësja e sëmundjeve të kafshët, kushtet e përgjithshme për lëshimin në qarkullim të kafshëve dhe të prodhimeve, importi, transiti i kafshëve, prodhimeve dhe lëndëve, financimi i mbrojtjes shëndetësore të kafshët dhe shëndetësia publike e veterinarisë dhe çështje tjera në lidhje me kryerjen e shëndetësisë së veterinarisë.

Neni 2

Qëllimet e Ligjit Qëllimet e këtij ligji janë:

- 1) identifikimi dhe rregullimi i aktiviteteve veterinarë të cilat janë me interes publik në kompetencë të shërbimit shtetëror veterinar;
- 2) përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të organeve të shërbimit shtetëror veterinar dhe të subjekteve me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj;
- 3) përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të personave përgjegjës për vendrritjen e kafshëve dhe objekteve dhe personave tjerë juridikë dhe fizikë të përfshirë në aktivitetet të cilat janë të rregulluara me këtë ligj;
- 4) përcaktimi i kushteve për kryerjen e profesionit mjek ndaj mjekësisë veterinarë;
- 5) sigurimi i mbrojtjes së njerëzve dhe kafshëve nga sëmundjet të kafshët dhe zoonozat si dhe masat të cilat duhet të ndërmerren kundër këtyre sëmundjeve;
- 6) zbatimi i kontrolleve veterinarë të lidhura me prodhimin, lëshimin në qarkullim, importin, transitin e kafshëve, prodhimeve, nus-prodhimeve me origjinë shtazore dhe lëndëve të cilat mund të jenë bartëse të sëmundjeve të kafshët dhe njerëzit;
- 7) sigurimi i shoqërimi i detyrueshëm i mjekëve të mjekësisë veterinarë dhe përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Odës së Veterinarisë.

Neni 3

Definicionet Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë kuptim:

1. "Kafshë" është çdo kafshë kurrizore ose jo kurrizore (duke përfshirë kafshët ujore, zvarranikët dhe amfibet);
2. "Kanakar" është çdo kafshë e cila i takon llojeve të kafshëve të cilat si zakonisht rriten dhe ruhen, por nuk përdoret nga njeriu ose rritet në vendrritjen e kafshëve, dhe e cila gjatë lëvizjes është e shoqëruar nga pronari ose person tjetër përgjegjës;
3. "Kafshë shtëpiake" është çdo kafshë tokësore e ruajtur nga njeriu, duke përfshirë edhe kafshë kanakare shtëpiake dhe bletët me përjashtim të peshqve;
4. "Kafshë për therje" janë kafshët përveç bletëve dhe shpezëve, të dedikuara për bartje në thertore për therje ose qendër grumbullimi prej nga mund të dërgohen vetëm për therje;

5. "Kafshë" janë kafshë kanakare shtëpiake të llojeve: njëthundrak, lopë (duke përfshirë llojet Bison bison dhe Bubalus bubalis), derrat, dhentë, dhitë, lepujt, shpezët, bletët dhe kafshët e egra që ruhen;
6. "Kafshë për shumim dhe prodhimtari" janë gjedhët dhe kafshët për therje duke përfshirë edhe ato të dedikuara për shumim, marrjen e mishit, leshit dhe qumështit, për tërheqje, ekspozitë ose manifestime me përjashtim të kafshëve të cilat marrin pjesë në ngjarje kulturore ose sportive;
7. "Peshq" janë peshqit në të gjitha stadet e zhvillimit, duke përfshirë edhe vezët dhe mbetjet, të cilat: përherë ose përkohësisht jetojnë në ujëra të ëmbla: ruhen në ujëra deti; peshq primitivë lumi në formën e ngjalës (cyclostomata). Për peshq llogariten edhe gaforret dhe guacat;
8. "Shpezë" janë pulat, gjelat e detit, pulat afrikane, rosat, patokët, shkurtëzat, pëllumbat, fazanët, thëllëzat dhe struçtë (ratitae) të shumuara ose të ruajtura në lokal të mbyllur ose me rrethojë për shkak të rritjes ose ruajtjes për: shumim, prodhimin e mishit ose të vezëve për ushqim ose përtëritjen e popullimit të kafshëve të egra;
9. "Vezë për kllloçkë" janë vezët për inkubacion të bëra nga shpezët;
10. "Zogj njëditor" janë të gjithë zogjtë të cilët nuk kanë filluar me ushqim më të rinj se 72 orë, përveç rosave nga soji Cairina moschata ose melez të tyre të cilat mund të ushqehen;
11. "Njëthundrakët" janë kafshët e egra ose të buta nga lloji equidae (duke përfshirë zebrat) ose gomarët ose pasardhësit të fituar me kryqëzimin e këtyre llojeve;
12. "Akuakulturë" janë peshqit e gjallë, gaforret dhe butakët ujorë të cilët e kanë origjinën nga vendrritja e kafshëve, duke përfshirë edhe ato nga basenet natyrore me ujë të cilat janë të dedikuara për rritje;
13. "Prodhime nga akuakultura" janë prodhimet e fituara nga akuakultura, pa marrë parasysh se a janë të dedikuara për prodhimin e vezëve ose vezë peshku, ose të destinuara për ushqimin e njeriut;
14. "Kafshë të egra" janë sisorët e egër tokësorë të cilët gjuhen (duke përfshirë edhe sisorët e egër të cilët jetojnë në hapësirë të rrethuar në kushte të lira të ngjashme me atë që e posedojnë kafshët e egra) dhe zogjtë e egër të cilët nuk janë të përfshirë me definicionin "Kafshë e egër e ruajtur";
15. "Kafshë e egër e ruajtur" janë sisorët tokësorë ose shpendë të cilët nuk llogariten si kafshë kanakare shtëpiake dhe të cilët nuk janë lopë (duke përfshirë edhe llojet Babalus dhe Bison bison), derrat, delet, dhitë, dhe njëthundrakët shtëpiake, por rriten si kafshë shtëpiake. Kafshët e egra të cilat jetojnë në lokal të rrethuar në kushte të lirisë të ngjashme me atë që e posedojnë kafshët e egra, nuk llogariten si kafshë të egra të ruajtura;
16. "Kope" janë kafshë ose grup kafshësh të cilat ruhen në vendrritjen e kafshëve si tërësi epizootive. Nëse më tepër se një kope ruhet në të njëjtin vendrritje të kafshëve, çdo njëra nga këto kope formon njësi të veçantë dhe ka status të njëjtë shëndetësor;
17. "Vendrritje e kafshëve" është çdo aktivitet, ndërtim ose në rast të rritjes në vend të hapur, çdo vend ku kafshët janë përfshirë me këtë ligj, të cilat përbëjnë një ose më tepër kope mbahen, ruhen dhe së bashku përkujdesen;
18. "Objekt" është çdo shoqëri tregtare dhe person tjetër juridik ku ruhen kafshë, ose prodhohen, magazinohen, përpunohen prodhime me origjinë shtazore, nus-prodhime me origjinë shtazore dhe sende të destinuara për tregti;
19. "Person përgjegjës për rritjen e kafshëve" është çdo person fizik ose juridik i cili i posedon ose është përgjegjës për kafshët, madje edhe përkohësisht;
20. "Qendër grumbullimi" është vendrritja e kafshëve, vendgrumbullimi dhe tregje kafshësh, ku kafshët të cilat e kanë origjinën nga vende të ndryshme për ruajtjen e kafshëve grupohen së bashku

për arsye të formimit të dërgesave të kafshëve të destinuara për tregti. Këto qendra grumbullimi doemos duhet të jenë të lejuara në tërësi tregtare dhe ti plotësojnë kushtet nga neni 73 të këtij ligji;

21. "Tregtar" është çdo person fizik ose juridik i cili blen dhe shet kafshë për qëllime komerciale, drejtpërdrejt apo tërthorazi, i cili rregullisht bën qarkullim me kafshë dhe i cili më së voni në afat prej 30 ditësh pas blerjes së tyre të njëjtat i shet ose i zhvendos nga një lokal në tjetrin që nuk është pronë e tij, dhe që i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 72 nga ky ligj;

22. "Nus-prodhime me origjinë shtazore" janë trupa të tërë ose pjesë nga kafshët ose prodhime me origjinë shtazore të cilat nuk janë të dedikuara për përdorim të njerëzve, duke përfshirë dhi dhe lëkura, qeliza-vezë, embrione dhe farë;

23. "Lëndë e parë" është çdo prodhim shtazor i përdorur si përbërje për fitimin e prodhimeve të mishit ose prodhime tjera me origjinë shtazore, duke përfshirë edhe ekstrakte nga mishi, dhjamë kafshe i përpunuar, sediment nga dhjami ose ushuji, miell për gatim, miell nga mbështjellës të jashtëm, gjak i kripur ose i thatë, plazmë gjaku e kripur ose e thatë, të pastruara, të kripura ose të thara dhe/ose lukthe të përpunuar termikë, fshika të urinës dhe tëmthit dhe zorrëve ose për përgatitjen e hajeve të gatshme;

24. "Prodhime" janë prodhimet me origjinë shtazore, duke përfshirë nus-prodhimet me origjinë shtazore dhe ushqim bimor të kafshëve, veçanërisht për shkak të destinacionit të afërt, mund të shkaktojnë rrezik ndaj shëndetit të kafshëve, njeriut dhe mjedisit jetësor, me çka duhet t'u nënshtrohen kontroleve veterinare të përcaktuara me këtë ligj;

25. "Ushqim për kafshë" është çdo substancë ose prodhim duke përfshirë aditivët, të cilët janë të përpunuar, ose të papërpunuar dhe janë të dedikuar për shfrytëzimin si ushqim për kafshët;

26. "Shpëlarje" janë hedhurina të mjeteve të transportit ndërkombëtar dhe e gjithë hedhurina nga ushqimi i dedikuar për përdorim të njeriut, nga restorante dhe objekte hotelerie ose kuzhina, duke përfshirë kuzhinat në industri ose në amvisëritë;

27. "Lëndë" janë bartës jo të gjallë të agjensëve infektivë të cilët mund të jenë të përfshirë në bartjen e sëmundjeve ngjitëse;

28. "Vatër" është vendrritja e kafshëve ku kafshët përbëjnë një tërësi epizootike dhe ku në mënyrë zyrtare janë të vërtetuara një ose më tepër raste të sëmundjeve ngjitëse të kafshët;

29. "Të dyshuar në sëmundje" janë ato kafshë të cilat tregojnë shenja klinike të sëmundjeve të kafshët;

30. "Të dyshuar në sëmundje ngjitëse" janë ato kafshë për të cilat llogaritet se janë të infektuara ose të sëmura me sëmundje ngjitëse, me apo pa shenja klinike të sëmundjes;

31. "Zoonoza" është çfarë do sëmundje dhe/ose infeksion e cila bartet në rrugë të natyrshme, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga kafshët te njerëzit;

32. "Qendra për kontroll të sëmundjeve" është qendra për kontroll të sëmundjeve e cila i përkrah dhe koordinon masat për kontroll dhe çrrënjosjen e sëmundjeve epizootive;

33. "Plan për masa urgjente" është shumë paraprake e definuar e masave dhe veprimeve të cilat duhen doemos të zbatohen në rast të shfaqjes së sëmundjes epizootive;

34. "Zonë e mbrojtur" është rajon gjeografik i përcaktuar në të cilin zbatohen masa të caktuara për çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshët;

35. "Zonë e mbikëqyrjes" është rajon gjeografik i përcaktuar në të cilin zbatohen masa të caktuara për preventivë të zgjerimit të sëmundjeve të kafshët;

36. "Karantinë" është masë për mbrojtje nga zgjerimi i sëmundjeve të kafshët e cila nënkupton ruajtjen e kafshëve në izolim në lokal special dhe për periudhë të caktuar kohore;

37. "Lëshim në qarkullim" është çdo procedurë qëllimi i së cilës është transferimi i kafshëve, prodhimeve ose nus-prodhimet me origjinë shtazore, ose çdo formë tjetër e dërgesës, me ose pa pagesë, ose magazinimin me qëllim furnizimin e subjektit tjetër;
38. "Vend veterinarie për inspektim në kalim kufitar" është çdo seksion për inspektim, e fiksuar në kufirin e jashtëm dhe i lejuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, për zbatimin e kontrolleve veterinarë të kafshëve, prodhimeve ose nus-prodhimeve me origjinë shtazore të cilat hyjnë në, apo kalojnë nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë nga shtetet tjera;
39. "Kontroll veterinar" është çdo kontroll zyrtar i dokumenteve, identitetit ose kontrollit fizik duke përfshirë marrjen e mostrës, e cila kryhet ndaj kafshëve, prodhimeve, nusprodhimeve me origjinë shtazore ose lëndëve për arsye të mbrojtjes së drejtpërdrejtë ose në mënyrë tjetër, mbrojtjes së shëndetësisë veterinarë ose shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve;
40. "Kontroll i dokumenteve" është kontrolli i certifikatave veterinarë-shëndetësore ose dokumenteve tjera të cilat e shoqërojnë dërgesën;
41. "Kontroll zyrtar" është çdo kontroll që organi kompetent e zbaton për vërtetimin e përshtatshmërisë me dispozitat për mbrojtje shëndetësore të kafshëve, shëndetësinë publike veterinarë dhe mirëqenia e kafshëve;
42. "Kontroll i identitetit" është inspektim vizual me të cilin përcaktohet se certifikata shëndetësore-veterinarë ose dokument tjetër të siguruar në pajtim me dispozitat nga sfera e shëndetësisë veterinarë, përgjigjet në dërgesën;
43. "Kontroll fizik" është kontrolli i paketimit, shënimit dhe gjendjes momentale të vetë dërgesës dhe mund të përfshijë marrjen e mostrave dhe ekzaminimit laboratorik;
44. "Verifikim" është kontrolli me ekzaminim dhe sigurim të dëshmive objektive se kërkesat e përcaktuara janë plotësuar;
45. "Inspektim" është ekzaminimi sistematik dhe i pavarur që të caktohet se vallë aktivitetet dhe rezultatet e tyre janë në pajtueshmëri me përgatitjet e planifikuara dhe se a janë zbatuar në mënyrë efektive dhe a janë përkatëse për arritjen e qëllimeve;
46. "NASSR" është sistem që i identifikon, vlerëson dhe kontrollon rreziqet të cilat janë të rëndësishëm për sigurinë e ushqimit;
47. "Inspeksion shëndetësor-veterinarë" është shuma e aktiviteteve të ndërmarra nga veterinar i zyrtar ose veterinar i autorizuar për shkak të përcaktimit të statusit shëndetësor të kafshët duke përfshirë edhe mirëqenien e tyre;
48. "Inspektim" është çdo veprim i ndërmarrë nga veterinar i zyrtar ose i autorizuar për shkak të kontrollit të përshtatshmërisë me dispozitat e këtij ligji;
49. "Import" është futja e kafshëve dhe/ose prodhimeve për shkak të lëshimit në qarkullim, që e kanë origjinën nga shteti tjetër në Republikën e Maqedonisë;
50. "Importues" është personi i theksuar si pranues në certifikatën shëndetësore-veterinarë ose dokument tjetër që e shoqëron dërgesën, në emër të të cilit dërgesa importohet në Republikën e Maqedonisë;
51. "Transit" është bartja e kafshëve, prodhimeve dhe nus-prodhimeve me origjinë shtazore nëpërmjet Republikës së Maqedonisë nga një shtet ose pjesë të tij, në shtet tjetër;
52. "Eksport" është nxjerrja jashtë e kafshëve dhe/ose prodhimeve apo nus-prodhime me origjinë shtazore nga territori i Republikës së Maqedonisë;

53. "Rieksport" është eksporti i prodhimeve të cilat gjatë importit nuk kanë qenë të lëshuara në qarkullim por kanë qenë të shënuara për eksport nga inspektimi kufitar, pas magazinimit të tyre të përkohshëm, paketimit ose përpunimit të mëtutjeshëm;
54. "Mjete transporti" janë mjetet për komunikacion rrugor ose mjete transporti hekurudhor, pjesë nga anijet dhe aeroplanët, të cilat përdoren për transport të kafshëve, prodhimeve dhe nus-prodhimeve me origjinë shtazore, duke përfshirë edhe pajisjen për ngarkim;
55. "Person përgjegjës për dërgesën" është çdo person i autorizuar, i cili ka detyrë ta paraqesë dërgesën për kontroll në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të ndërmarrë veprime përkatëse si rezultat i këtyre kontrolleve;
56. "Dërgesë" është numri i caktuar i kafshëve, numri i kufizuar ose sasi të prodhimeve ose nus-prodhimeve me origjinë shtazore me tip të njëjtë, të përfshirë me certifikatë të njëjtë veterinarie-shëndetësore ose dokument tjetër i siguruar në pajtim me dispozitat nga sfera e shëndetësisë veterinarë, të transportuara me mjet transporti të njëjtë, të cilat vijnë nga shteti i njëjtë ose pjesë e tij të cilat e kanë origjinën nga dërguesi i njëjtë dhe të cilat janë të dedikuara për dërgues të njëjtë;
57. Njësi epizootologjike" është rajoni gjeografik dhe/ose administrativ i cili përfshin një komunë;
58. "Rajon epizootologjik" është rajoni gjeografik dhe/ose administrativ i cili përfshin dy apo më tepër komuna fqinje të përcaktuara nga ana e ministrit për arsye të organizimit dhe eksportimit të shërbimeve veterinarë me interes publik, në pajtim me dispozitat nga sfera e shëndetësisë veterinarë;
59. "Ndihmë e parë veterinarë" është përfshirja me të cilën mënjanohet rreziku i drejtpërdrejtë ndaj jetës së kafshës;
60. "Ministri" është ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
61. "Ministër" është ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
62. "Veterinar zyrtar" është veterinar i kualifikuar, në bazë të dispozitave nga ky ligj, i punësuar në organin kompetent për kryerjen e inspektimeve veterinarë, në vendin e punës "inspektor shëndetësor veterinar";
63. "Veterinar i autorizuar" është veterinar i kualifikuar, në bazë të dispozitave nga ky ligj, i autorizuar nga drejtori për kryerjen e inspektimeve veterinarë, si autorizim publik, nën mbikëqyrje dhe përgjegjësi të organit kompetent;
64. "Organ kompetent" është Drejtoria për veterinar si organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
65. "Drejtor" është drejtori i Drejtorisë për veterinar;
66. "Shërbim shtetëror veterinar" është shërbimi i cili e zbaton veprimtarinë e veterinarisë me interes publik në territorin e Republikës së Maqedonisë;
67. "Trup, institut ose qendër e lejuar" është çdo subjekt gjeografik i përcaktuar dhe nën mbikëqyrjen e organit kompetent, ku një apo më tepër lloje të kafshëve ruhen dhe rriten, me apo pa qëllim komercial dhe veçanërisht për në apo më tepër nga qëllimet vijuese: ekspozimi i kafshëve dhe edukimi i publikut, ruajtja e llojeve, hulumtime themelore të zbatueshme dhe shkencore ose ruajtje e kafshëve për nevojat e atyre hulumtimeve (panair, ekspozim, cirk, kopsht zoologjik, qendër eksperimentale dhe tjera).

Veprimtaria veterinare me interes publik Mbrojtja shëndetësore e kafshëve, shëndetësia veterinare publike dhe mirëqenia dhe mbrojtja e kafshëve janë veprimtari veterinare me interes publik.

KREU II

Organizimi dhe përgjegjësia në kryerjen e veprimtarisë veterinare

Seksioni I

Organizimi dhe përgjegjësia në shërbimin veterinar

Neni 5

Shërbimi shtetëror veterinar

(1) Veprimtarinë veterinare me interes publik në territorin e Republikës së Maqedonisë, e zbaton Shërbimi veterinar shtetëror në bashkëpunim me organe dhe institucione tjera, përmes:

- 1) Ministrisë, ministrit;
- 2) organit kompetent, drejtorit dhe
- 3) laboratorit nacional referent kur punon në marrëveshje me Ministrinë, për nevojat e organit kompetent.

(2) Shërbimi shtetëror veterinar është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve vijuese:

- 1) mbikëqyrjen, diagnozën, çrrënjosjen dhe preventivën e sëmundjeve ngjitëse të kafshët dhe zoonozat dhe plotësimin e detyrimeve nacionale dhe ndërkombëtare për njoftim;
- 2) kontrollimet zyrtare për lëshimin e certifikatave për gjendjen shëndetësore të kafshëve dhe shëndetësisë publike veterinare, mbajtjen e regjistrave dhe identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve për arsye të mbrojtjes shëndetësore të kafshëve;
- 3) mirëmbajtjen e nivelit të lartë të mbrojtjes shëndetësore të kafshët, produktivitetit dhe mirëqenien e tyre dhe mbrojtjen e njerëzve dhe mjedisit jetësor nga agjensë të dëmshëm të cilat barten përmes kafshëve, lëndës së parë, prodhimeve, nus - prodhimeve me origjinë shtazore dhe lëndëve;
- 4) planifikimin dhe propozimin e masave për dezinfektim, dekontaminim, sanimin, deodorimin dhe rrënjosjen e dëmtuesve;
- 5) kontrollin e prodhimit, qarkullimit dhe përdorimit të preparateve veterinare - shëndetësore dhe prodhimeve tjera të dedikuara për përdorim në shëndetësinë veterinare;
- 6) kontrollin e prodhimit, qarkullimit dhe përdorimit të ushqimit për kafshë;
- 7) përcjelljen, analizën dhe vlerësimin e ndikimit të mjedisit jetësor dhe natyrës ndaj shëndetit të njeriut;
- 8) vendosjen dhe kontrollimin e kushteve higjienike dhe proceseve teknologjike në vendrritjen e kafshëve dhe objektet dhe
- 9) trajnimin dhe aftësimin profesional të mjekëve në mjekësinë veterinare, ngritjen e vetëdijes dhe informimin e ruajtësve të kafshëve, prodhuesve dhe publikut në raport me qëllimet, metodat dhe procedurat për plotësimin e aktiviteteve nga pika 1 deri në 8 nga ky paragraf.

Neni 6

Organizimi dhe përgjegjësia e Shërbimit veterinar në ARM

(1) Shërbimi veterinar në Armatën e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARM) është shërbim i mëvetësishëm profesional, i formuar në kuadrin e ARM, e cila kryhen veprimtari në pajtim me dispozitat e këtij ligji, për nevojat e ARM-së.

(2) Shërbimi veterinar i ARM dhe organi kompetent bashkëpunojnë dhe profesionalisht e harmonizojnë punën e tyre.

Neni 7

Kompetencat e Ministrisë Ministria kujdeset për zbatimin e politikës në kryerjen e veprimtarisë veterinare në sferën e shëndetësisë veterinare dhe shëndetësisë publike veterinare.

Neni 8

Aktivitetet e ministrit

(1) Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave i bën këto aktivitete:

1) miraton listën e sëmundjeve të cilat detyrimisht paraqiten;

2) miraton urdhëresa vjetore për mbrojtjen shëndetësore të kafshëve dhe për shëndetësinë veterinare publike;

3) siguron shkallë të lartë të koordinimit me organe tjera të Drejtorisë shtetërore për zbatimin e aktiviteteve nga sfera e shëndetësisë veterinare;

4) jep mendim për marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale nga sfera veterinare;

5) lëshon dhe tërheq aktvendime për autorizim për kryerjen e veprimtarisë veterinare me interes publik;

6) përcakton laboratorë referentë (vendase ose të huaj) sipas procedurës së zbatuar paraprakisht në konkurs publik, e përcakton rajonin në nivelin e veprimit të tyre, si dhe detyrimet e tyre në pajtim me këtë apo atë ligj nga sfera e shëndetësisë veterinare;

7) i përcakton kufijtë e rajoneve epizootologjike dhe

8) bën edhe punë të tjera, të përcaktuara me këtë apo tjetër ligj.

(2) Aktivitetet nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërmerren ndaj propozimit të paraqitur me shkrim nga drejtori i Drejtorisë për veterinar.

Neni 9

Përgjegjësia e organit kompetent

(1) Drejtoria për veterinar është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;

(2) Drejtoria për veterinar e ka cilësinë e personit juridik.

(3) Drejtoria për veterinar (në tekstin e mëtutjeshëm: organi kompetent), si organ kompetent është përgjegjëse për zbatimin, kontrollin, mbikëqyrjen dhe kontrollimin e aktiviteteve veterinare në sferën e mbrojtjes shëndetësore të kafshët, mirëqenien e tyre, shëndetësia publike veterinare, si dhe

kontroll të laboratorëve referentë dhe laboratorët veterinarë, në pajtim me këtë apo tjetër ligj nga sfera e shëndetësisë veterinarë dhe sigurimi i ushqimit me origjinë shtazore.

(4) Organi kompetent punët nga kompetenca e vet i kryhen edhe në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare që i ratifikon Republika e Maqedonisë, Standardet ndërkombëtare të Organizatës botërore për mbrojtje shëndetësore të kafshëve (OIE) si dhe me akte tjera dhe standarde me të cilat obligohet Republika e Maqedonisë.

Neni 10

Aktivitetet e drejtorit të Drejtorisë për veterinarë Drejtori i Drejtorisë për veterinarë:

- 1) siguron zbatimin e aktiviteteve veterinarë të përfshira me dispozitat nga sfera shëndetësisë veterinarë, kryen kontroll, inspektim dhe kontroll të zbatimit të tyre, kryen ekzaminime të përbashkëta dhe aktivitete me organizatat vendase dhe të huaja, për punë me kompetencë të tyre;
- 2) i propozon ministrit listën e sëmundjeve të cilat detyrimisht paraqiten;
- 3) i propozon ministrit miratimin e ligjeve dhe dispozitave tjera dhe akteve nga sfera e shëndetësisë veterinarë;
- 4) miraton aktvendime për masa sigurie për import, transit, dhe eksport të kafshëve dhe prodhimeve;
- 5) miraton aktvendime për zbatimin e kontrollit të sëmundjeve dhe zbatimit të masave mbrojtëse;
- 6) lidh marrëveshje me ambulancat veterinarë, klinikat dhe spitalet;
- 7) lëshon dhe anulon leje nga neni 71, 72, 73 dhe 74 nga ky ligj;
- 8) i koordinon, mbikëqyr dhe përcjell aktivitetet nga sfera e mbrojtjes shëndetësore të kafshëve dhe shëndetësisë publike veterinarë;
- 9) siguron përgatitjen e planeve për masa urgjente, programe, buxhet dhe aktivitete tjera më korniza të kompetencave të veta, i paraqet për miratim ministrit dhe siguron zbatimin e tyre;
- 10) siguron kushte për nivel përkatës të edukimit të personelit i cili do të punojë në ambulancat veterinarë, klinika, spitale dhe institucione tjera nën përgjegjësi të organit kompetent, si dhe trajnim i rregullt i brendshëm për personalin ekzistues dhe trajnim ekspertësh në sfera të ndryshme;
- 11) jep orientime për prioritetet në hulumtimet në sferën veterinarë duke i pasur parasysh nevojat nacionale;
- 12) udhëheq me personelin dhe buxhetin vjetor të organit kompetent në pajtim me dispozitat e këtij ligji;
- 13) e këshillon ministrin për orientimet dhe prioritetet në sferën e shëndetësisë veterinarë dhe
- 14) bën edhe punë të tjera, të përcaktuara me ligj.